



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

NJOFTIM PËR MEDIA

Referuar raportimeve të mëparshme në media, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, informon sa më poshtë:

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, është zhvillua çështja penale që i përket të pandehurve me initiale **F. T** dhe **V. O**, të akuzuar për kryerjen e veprës penale "*Vrasje me paramendum*" e kryer në bashkëpunim dhe "*Mbajtje pa leje të armëve luftarake*", parashikuar nga nenet 78/1 e 25, 278/2 të K. Penal.

Fakti objekt akuze lidhet me ngjarjen e ndodhur më datë 09.08.2007, ku në afërsi të stanit të tij, në vendin e quajtur "Mocale", në fshatin Bestrov të rrethit Vlorë, është gjetur i vrarë me armë zjarri shtetasi me initiale K. G. Të dyshuar për kryerjen e kësaj vepre penale janë të pandehurit me initiale F. T dhe V. O.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin **nr. 309, datë 11.09.2009 ka vendosur:**

1. Të deklarojë të pafajshëm të pandehurin **F. T**, për kryerjen veprave penale të "*Vrasje me paramendum*" dhe atë të "*Mbajtjes pa leje të armëve luftarake*", parashikuar nga nenet 78/1 e 25 dhe 278/2 të Kodit Penal.
2. Të deklarojë të pafajshëm të pandehurin **V. O**, për kryerjen veprave penale të "*Vrasje me paramendum*" dhe atë të "*Mbajtjes pa leje të armëve luftarake*", parashikuar nga nenet 78/1 e 25 dhe 278/2 të Kodit Penal.
3. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm nga salla e të pandehurve **F. T** dhe **V. O**.

*Çështja në apel është shqyrtuar mbi bazën e ankimit të bërë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila kërkoi ndryshimin e vendimit dhe deklarimin fajtor të të pandehurve për kryerjen e veprave penale të "*Vrasje me paramendum*" dhe "*Mbajtje pa leje të armëve luftarake*".*

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin **nr. 401, datë 01.12.2010 ka vendosur:**

-Prishjen e vendimit nr. 309, datë 11.09.2009 të Gjykatës së shkallës së parë Vlorë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim po asaj gjykate me tjetër trup gjykues.

Ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, është ushtruar rekurs nga të pandehurit F. T dhe V.O, të cilët kanë kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë.

Gjykata e Lartë me vendimin nr. 194, datë 12.06.2013 ka vendosur:

“Prishjen e vendimit nr. 401, datë 01.12.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë tjetër trup gjykues”.

Në vijim, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 36, datë 12.11.2013 ka vendosur:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 309, datë 11.09.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe duke e gjykuar çështjen në fakt:
 - Të deklarojë fajtor të pandehurit **F. T e V. O**, për kryerjen veprës penale të **“Vrasje me paramendim”** dhe sipas nenit 78/1 e 25 të Kodit Penal I dënon me nga 18 vjet burg secilin.
 - Të deklarojë fajtor të pandehurit **F. T e V. O**, për kryerjen veprës penale të **“Armëmbajtjes pa leje”** dhe sipas nenit 278/2 të Kodit Penal, I dënon nga 3 vjet burg secilin.
 - Në bazë të nenit 55 të Kodit Penal I dënon me nga 18 vjet secilin.

Edhe ndaj vendimit të lartpërmendur, është ushtruar rekurs nga të pandehurit F. T dhe V.O, të cilët kanë kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e akteve për rishqyrtim me tjetër trup gjykues. Në alternativë, prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë.

Gjykata e Lartë me vendimin nr. 137, datë 10.05.2022 ka vendosur:

“Prishjen e vendimit nr. 36, datë 12.11.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

Në përfundim të gjykimit, Prokurori pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, z. Kleanth Zeka, kërkoj:

- Ndryshimin e vendimit nr. 309, datë 11.09.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në këtë mënyrë:
- Deklarimin fajtor të të pandehurit **F. T**, për kryerjen e veprës penale të **“Vrasje me paramendim”**, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 78/1 dhe 25 i K.Penal dhe dënimin e tij me 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit F.T, për kryerjen e veprës penale të “Mbajtja pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.
- Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit F.T me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit V.O, për kryerjen e veprës penale të “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 78/1 dhe 25 i K.Penal dhe dënimin e tij me 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit V.O, për kryerjen e veprës penale të “Mbajtja pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.
- Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55 të K.Penal, dënimin e të pandehurit V.O me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim.
- Shpenzimet procedurale në ngarkim të të pandehurve solidarisht

Mbrojtësit e të pandehurve V. O dhe F. T, kërkuan:

- Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së parë Vlore, që ka deklaruar të pafajshëm të pandehurit V. O dhe F. T, për veprën penale "Vrasje me paramendim" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 78 i K. Penal.

Në përfundim të gjykimit, më datë 24.07.2024, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e përbërë nga trupi gjykues me Relatore Gjyqtare z. Genti Dokollari dhe anëtare znj. Irena Brahimi dhe z. Fuat Vjerdha, vendosi:

-Ndryshimin e vendimit nr. 309, datë 11.09.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si vijon:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **F. T**, për kryerjen e veprës penale të “**Vrasje me paramendim**”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 78/1 dhe 25 i K. Penal dhe dënimin e tij **me 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim.**
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **F. T**, për kryerjen e veprës penale të “**Mbajtja pa leje të armëve luftarake**”, parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij **me 3 (tre) vjet burgim.**
3. Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55 të K. Penal, dënimin e të pandehurit **F. T me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim.**
4. Deklarimin fajtor të të pandehurit **V. O**, për kryerjen e veprës penale të “**Vrasje me paramendim**”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 78/1 dhe 25 i K. Penal dhe dënimin e tij **me 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim.**
5. Deklarimin fajtor të të pandehurit **V. O**, për kryerjen e veprës penale të “**Mbajtja pa leje të armëve luftarake**”, parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij **me 3 (tre) vjet burgim.**

6. Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55 të K. Penal, dënimin e të pandehurit **V. O me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim.**

GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

[Shqiptarja.com]